



# FLETORJA ZYRTARE

E KRAHINËS AUTONOME TË KOSOVË — METOHIS

## Dispozitat e këshillave popullore — (shtesë)

№ 23

Prishtinë me 12 Dhetuer 1955

Vjeti III

Në bazë të nenit 57 pika 2 të Ligjit mbi këshillat popullore të prëtheve e në lidhje me nenin 19 pika 1 e Ligjit themelues mbi buxhetet, — Këshilli popullor i rrethit të Prishtinës në mbledhjet e Dhomës së rrethit dhe të Dhomës së prodhuesave mbajt me 26 Tetuer të vjetit 1955 muer këtë

### V E N D I M

#### MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTSIMIN E VENDIMIT TË BUXHETIT T'ARDHUNVE DHE TË DALUNAVE TË KESLILLIT POPULLUER TË RRETHIT GRAÇANICË PËR VJETIN 1955

Neni 1

Mbas nenit 3 të vendimit në fjalë shtohet neni i ri 3-a i cili është si vijon:

Tanë teprica e t'radhunave simbas buxhetit të Këshillit popullor të rrethit të Graçanicës për vjetin 1955 e cila do të realizohet, do të derdhët në fondin investicional — nenpjesa VIII, pjesa 1, partija 33, pozicjoni 2.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare të Krahinës Autonome të Kosovës e Metohis, e do të zbatohet prej ditës kur është marrë.

Nr.4494/55  
26/Tetuer 1955  
Prishtinë

#### KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT TË PRISHTINËS

KRYËTARI  
Eihami Nimani. d.v.

Në bazë të nenit 42, alineja 5, pika 2 e Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe të nëpunsave dhe nenit 16 alineja 1 pika 2 e Dekretligjit mbi organizimin e Institutit për sigurimin social, Kuvendi i Institutit të sigurimit social për rreth në Gillan në mbledhjen mbajtë me 11 nanduer të vjetit 1955 muer këtë

### V E N D I M

#### MBI TË DREJTEN NË SHPENZIMET E UDHËTIMIT NË RAST TË DERGIMIT TË TË SIGURUEMIT NË VEND TË NDRYSHME

1) Të siguruemit kanë të drejtë në shpenzimet e udhëtimit, (shpenzimit e transportimit dhe shpen-

zimet e ushqimit dhe të fjetjes edhe në rastet kur si të paaftë përkohësisht për punë dergohen për me ndrue vendin në vend tjetër mbrenda kufijve të rrethit si edhe jashtë kufijve të rrethit.

2) Shpenzimet për ushqim dhe fjetje në rastet nga pika 1 e këtij vendimi takojnë vetëm gjatë udhëtimit, e jo edhe qëndrimit në vendin tjetër, e paguhen në shumën dhe nen kushtet e vendimit të këtij kuvendi sa është shuma e shpërbllimit për shpenzimet e ushqimit dhe fjetjes gjatë udhëtimit dhe të qëndrimit në vend tjetër. Nr.2466/4 datë 11/XI/1955.

3) Ky vendim do të zbatohet prej datës 11 nanduer të vjetit 1955.

4) Me ditën e caktueme kur fillon me u zbatue ky vendim, aburgohen të gjitha vendimet e marruna në bazë të nenit 42 alineja 5 pika 2 e Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe nëpunsave deri me këtë datë për teritorin e rrethit t'ardhëshëm të Gillanit.

Nr.2477/3  
në Gillan me 11/XI/1955

#### INSTITUTI PËR SIGURIMIN SOCIJAL PËR RRETH

DREJTORI  
Jelica Stojanoviç. d.v.

Në bazë të nenit 44 të Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe nëpunsave, vendimit Nr. 3010 datë 19 Kallnuer të vjetit 1955 të Kuvendit t'Institutit Republikan për sigurimin social të RPS mbi shumën e shpërbllimit për shpenzimet e ushqimit dhe të fjetjes /Fletorja Zyrtare e RPS Nr.7/55/ dhe nenit 16 alineja 1 pika 2 të Dekretligjit mbi organizimin e Institutit për sigurimin social, — Kuvendi i Institutit të sigurimit social për rreth në Gillan në mbledhjen mbajtë me 13/XI/1955 muer këtë

### V N D I M

#### MBI SHUMËN E SHPËRBLIMIT PËR SHPENZIMET E USHQIMIT DHE FJETJES GJATË UDHËTIMIT DHE QËNDRIMIT NË VEND TJETËR

1. Shpenzimet e ushqimit dhe fjetjes gjatë udhëtimit dhe qëndrimit në vend tjetër jepën në shumën prej 500 dinarësh.

Shpërbllimi nga alineja e sipërme për rastet e udhëtimit dhe të qëndrimit në:

- a) Kufit e rrethit është: — — — 400 dinarë  
b) Jashtë kufijve të rrethit është — 500 "

2. Fëmijve të sigruemve deri në moshën 7 vjeçare u takon gjysma e shumës së shpërbllimit të shpenzimeve të caktueme me këtë vendim.

3. Shpenzimet e ushqimit dhe të fjetjes gjatë udhëtimit dhe qëndrimit në vend tjetër llogariten dhe pa-

guhen në veshtrim të dispozitave të Dekretligjit mbi shpenzimet e udhëtimit dhe të shpërnguljës.

4. Ky vendim do të zbatohet çprej datës 11/XI/1955.

5. Me ditën e caktueme kur fillon me u zbatue ky vendim abrogohen të gjithë vendimet mbi shumën e shpenzimeve që jepën për ushqim dhe fjetje gjatë udhëtimit dhe qëndrimit në vend tjetër të marruna deri me atë datë nga teritori i rrethit t'ardhëshëm.

Nr. 2477/4

Në Gilan me 11/XI/1955

**ENTI I SIGURIMIT SOCIJAL PËR RRETH**

DREJTORI

Jelica Stojanović d.v.

Në bazë të nenit 42 alineja 5 pika 1 e Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe nëpunsave dhe nenit 16 alineja 1 pika 2 e Dekretligjit mbi organizimin e Institutit për sigurimin social,— Kuvendi i Institutit të sigurimit social për rreth në Gilan në mbledhjen mbajtë me 11/XI/1955 muer këtë

**V E N D I M**

**MBI TË DREJTËN NË SHPENZIMET E UDHËTIMIT NË RASTË UDHËTIMI DERI TE MJEKU OSE THEMELATA SHËNDETSORE MA E AFERTË NË VEND TJETËR**

1. Të siguruemët gjegjësisht antarët e familjës të siguruemve kanë të drejtë në shpenzimet e udhëtimit (në shpenzimet e transportimit dhe shpenzimet e ushqimit dhe të fjetjës) edhe në rastet kur shkojnë prej vendit ku punojnë gjegjësisht vend banimit të përherëshëm ku nuk ka mjek, për t'u vizitue te mjeku ose me u mjekue deri te mjeku ma i afërmë ose themelata shëndetsore ma e afërmë në vend tjetër, nëqoftë se simbas çmimit të mjekut gjegjësisht themelatës shëndetsore vizita mjeksore ose mjekimi ka qënë i nevojshëm.

2. Shpenzimet e ushqimit dhe fjetjës në rastet nga pika 1 e këtij vendimi paguhën në shumën prej 400 dinarëve në veshtrim të dispozitave të Dekretligjit mbi shpenzimet e udhëtimit dhe të shpërnguljës.

3. Ky vendim do të zbatohet prej datës 11/XI/1955.

4. Në ditën e caktueme kur fillon me u zbatue ky vendim abrogohen të gjitha vendimet e marruna në bazë të nenit 82 alineja 5 pika 1 e Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe nëpunsave deri n'atë datë për teritorin e rrethit tashëm të Gilanit.

Nr. 2477

në Gilan me 11/XI/1955

**INSTITUTIT PËR SIGURIMIN SOCIJAL PËR RRETH**

DREJTORI

Jelica Stojanović d.v.

Në bazë të nenit 33 të Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe nëpunsave dhe nenit 16 alineja 1 pika 2 e Dekretligjit mbi organizimin e Institutit të sigurimit social, Kuvendi i Institutit të sigurimit social për rreth në Gilan në mbledhjen mbajtë me 11/XI/1955, muer këtë

**V E N D I M**

**MBI VAZHDIMIN E JASHTËZAKONSHËM TË DREJTËS NË SHPËRBLIM NË VEND TË RROGËS GJATË KUJDESËS PËR ANTARIN E SËMUT TË FAMILJES SË NGUSHT**

1. Të siguruemit i lejohet vazhdimi i të drejtës në shpërblim në vend të rrogës mbi 7 ditë—nëqoftë se antari i sëmut i familjës, asht ma i moçëm se 14 vjeç gjegjësisht mbi 15 ditë nëqoftë se antari i sëmut i familjës së ngusht asht nën 14 vjeç në rastë kur në bazë të propozimit t'arsyetuem të mjekut kompetent të shërbimit publik shëndetsuer vërtetohet nevoja e mungesës nga puna të siguruemit dhe gjatë t'asaj kohe të kujdesohet për antarin e sëmut të familjës së ngusht.

2. Vazhdimin e të drejtës në shpërblim në vend të rrogës në rastet nga pika e sipërme lejohet në këto rrethana:

a) Nëqoftë se nuk ka mundsi m'u vendos antari i sëmut i familjës në themelatën shëndetsore të vendit gjegjësisht nëqoftë se nuk ka nevojë për shërim të spitalit dhe

b) Nëqoftëse i siguruemi kur ka në shtëpi person madhuer t'afte e që nuk punon gjegjësisht person që nuk asht në shkollë.

3. Ky vendim do të zbatohet prej datës 11/XI/1955.

4. Në ditën e caktueme kur fillon me u zbatue ky vendim abrogohen të gjitha vendimet mbi vazhdimin e jashtëzakonshëm të drejtës në shpërblim në vend të rrogës gjatë kohës së kujdesit për antarin e sëmut të familjës, d.m.th. vendimet që janë marrë deri me këtë datë për teritorin e rrethit t'ardhëshëm të Gilanit.

Nr. 2477

në Gilan me 11 XI 1955

**INSTITUTI I SIGURIMIT SOCIJAL PËR RRETH**

DREJTORI

Jelica Stojanović d.v.

Në bazë të nenit 45 të Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe nëpunsave dhe nenit 16 alineja 1 pika 2 e Dekretligjit mbi organizimin e Institutit për sigurimin social,— Kuvendi i Institutit për sigurimin social të rrethit në Gilan në mbledhjen mbajtë me 11 XI 1955 muer këtë

**V E N D I M**

**MBI RASTET DHE KUSHTET NË BAZË TË CILAVE JEPET SHPËRBLIMI PËR SHPENZIMET E UDHËTIMIT PËR PËRCJELLËSIN**

1. Shpenzimet e udhëtimit i takojnë përcjellsit i cili qëndron gjatë mjekimit në themelatën shëndetsore me të sëmutin—që gëzon mbrojtjen shëndetsore në këto raste:

a) kur simbas mendimit të themelatës shëndetsore të sëmutit të cilit simbas çmimit të mjekut të shërbimit shëndetsuer publik i asht caktue përcjellsit gjatë udhëtimit dhe mjekimit në vendin tjetër e ky përcjellsit asht i domosdoshëm gjatë mjekimit n'atë themelatë.

b) Kur fëmija deri më 7 vjeç dergohet në vend mjekim natyral t'organizuem si themelat shëndetsore dhe ky mjekim asht i domosdoshëm për të;

c) Kur për personin e siguruem mbi 7 vjet i cili dergohet në vend mjekim natyral t'organizuem si themelat shëndetsore për mjekim të domosdoshëm, e simbas çmimit të komisionit të mjekve gjatë qëndrimit të tij në këtë mjekim asht i domosdoshëm përcjellsi.

2. Shpërblimi për shpenzimet e udhëtimit simbas këtij vendimi njihet edhe me rastin kur themelata shëndetsore gjindet në vendin ku punon ose të qëndrimit të përhershëm të sëmëndit gjegjësisht të përcjellsit nën kushtet nga pika e sipërme.

3. Shpenzimet e udhëtimit simbas këtij vendimi llogariten dhe i paguhet të siguruemit në shumën dhe nën kushtet e vendimit të këtij kuvendi mbi shumën e shpërblimit për shpenzimet e ushqimit dhe fjetjes gjatë udhëtimit dhe qëndrimit në vend tjetër Nr.2477/4 datë 11 XI 1955.

4. Shpenzimet e udhëtimit për përcjellsin gjatë udhëtimit njihen nën kushtet e nenit 45 alineja 1 e Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe nëpunsave.

5. Në rastë kur përcjellsi në themelaten shëndetsore e ka ushqimin e plot dhe fjetjen, në rastë të shpërblimit nga pika 3 e këtij vendimi do t'i paguhet themelates shëndetsore shpenzimet e vërteta t'ushqimit dhe të fjetjes të përcjellsit.

6. Ky vendim do të zbatohet prej datës 11 XI 1955.

7. Në ditën e caktueme kur fillon zbitimi i këtij vendimi abrogohen të gjitha vendimet e marruna deri n'atë datë në bazë të nenit 45 të Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe nëpunsave nga territori i rrethit t'ardhshëm të Gilanit.

Nr. 2477/5

në Gilan me 11 XI 1955

#### INSTITUTI I SIGURIMIT SOCIJAL PËR RRETH

DREJTORI

Jelica Stojanović d.v.

Në bazë të nenit 40 të Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe nëpunsave dhe nenit 10 alineja 1 pika 2 të Dekretligjit mbi organizimin e Institutit të sigurimit social e tue pranue porosin e Kuvendit t'Institutit republikan për sigurimin social të RPS datë 19 Mars të vjetit 1955 (Fletorja Zyrtare e RPS Nr.7/55), Kuvendi i Institutit për sigurimin social në Gilan në mbledhjen e dytë mbajta me 11 XI 1955 muer këtë

#### V E N D I M

##### MBI NDIHMËN PËR PAJISJEN S FOSHJËS

1. Ndhma për pajisjen e foshnjës prej 8000 dinarësh caktue me nenin 43 të Dekretligjit mbi zbatimin e Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe nëpunsave, do të jepet për çdo foshnje në të holla.

2. Ky vendim do të zbatohet prej 11 XI 1955.

3. Në ditën e caktueme kur fillon me u zbatue ky vendim abrogohen të gjitha vendimet mbi mënyrën e ndihmës ndihmë për pajisjen e foshnjës d.m.th. vendimet e maruna deri n'at datë për territorin e rrethit të tashëm të Gilanit.

Nr. 2477/1

në Gilan me 11 XI 1955

#### INSTITUTI I SIGURIMIT SOCIJAL PËR RRETH

DREJTORI

Jelica Stojanović d.v.

Në bazë të nenit 47 të Ligjit mbi sigurimin shëndetsuer të puntorve dhe nëpunsave, vendimit Nr.3019 të Kuvendit t'Institutit Republikan për sigurimin social mbi kufit e shumave paushale, (Fletorja Zyrtare e RPS Nr. 7/55), — dhe nenit 16 alineja 1 pika 2 e Dekretligjit mbi organizimin e Institutit të sigurimit social në Gilan, Kuvendi i Institutit të sigurimit social për rreth në Gilan në mbledhjen mbajta me 11 XI 1955 muer këtë

#### V E N D I M

##### MBI SHUMËN PAUSHALE TË SHPËRBLIMIT PËR SHPENZIMET E VORROSJËS

1. Shuma paushale e cila paguhet n'emën të shpenzimeve të vorrosjës asht 11.000 dinarë.

2. N'emën të shpenzimeve të vorrosjës për antarin e vdekun të familjës deri në 7 vjeç paguhet gjysma e shumës paushale e caktueme me këtë vendim.

3. Ky vendim do të zbatohet prej datës 11 XI 1955.

4. Në ditën e caktueme kur fillon me u zbatue ky vendim abrogohen të gjitha vendimet mbi shumën paushale të shpërblimit për shpenzimet e vorrosjës gjegjësisht vendimet e marruna deri n'atë datë për territorin e rrethit të tashëm të Gilanit.

Nr. 2477/6

në Gilan me 11 XI 1955

#### INSTITUTI I SIGURIMIT SOCIJAL PËR RRETH

DREJTORI

Jelica Stojanović d.v.

Këshilli populluer i komunës Sllatinës në mbledhjen e mbajtun me 23 X 1955, në bazë të nenit 13, 15 dhe 16 të Ligjit mbi zgjedhjet dhe revokimin e këshilltarëve të këshillave popullore, në lidhje me nenin 2 alineja 6 pika 1 e Ligjit mbi kompetencat e këshillave popullore të komuneve në punë të rregullueme me dispozitat republikane muer këtë

#### V E N D I M

##### MBI SHPALLJEN E ZGJEDHJEVE PËR NJI VEND TË SHPRAZËT TË KËSHILLTARIT PËR KËSHILLIN POPULLUER TË KOMUNËS SË SLLATINËS

I. Shpallën zgjedhjet për një vend të shprazët të këshilltarit të Këshillit populluer të komunës së sllatinës në njisin zgjedhjore Nr. 11 — vendi zgjedhjuer Nr. 13 i cili përfshin katundin Sllatinë.

II. Zgjedhjet do të mbahen me 25 Dhetuer të vjetit 1955.

Nr. 504

në Sllatinë 31 X 1955

#### KËSHILLI POPULLUER I KOMUNËS SLLATINË

KRUËTARI

Dragolub Miletiq, d.v.

## PËRMBAJTJA

	Faqe
1. Vendimi mbi ndryshimin dhe plotsimin e vendimit të buxhetit t'ardhunave dhe të dalunave të Këshillit populluer të rrethit të Graçanicës për vjetin 1955. — — — — —	459
2. Vendimi mbi të drejtën në shpenzimet e udhëtimit në rastë të dergimit të siguruemit në vend të ndryshëm. — — — — —	459
3. Vendimi mbi shumën e shpërblimit për shpenzimet e ushqimit dhe të fjetjes gjatë udhëtimit dhe qëndrimit në vend tjetër. — —	459
4. Vendimi mbi të drejtën në shpërblimin e shpenzimeve t'udhëtimit në rastet e udhëtimit deri te mjeku ose themelata shëndetësore ma e aferme në vend tjetër. — — —	460
5. Vendimi mbi vazhdimin e jashtzakonshëm të drejtës në shpërblim në vend të rrogës gjatë kujdesit për antarin e sëmurë të familjës së ngushtë. — — — — —	460
6. Vendimi mbi rastet dhe kushtet nën të cilat takojnë shpenzimet e udhëtimit për përcjellsin. — — — — —	460
7. Vendimi mbi ndihmën për pajisjen e foshnjës.	461
8. Vendimi mbi shumën paushale të shpërblimit për shpenzimet e vorrosjes. — — — —	461
9. Vendimi mbi shpalljen e zgjedhjeve për një vend të shprazët të këshilltarit të Këshillit populluer të komunës Sllatinës. — — —	462

**E boton Këshilli egzekutiv i KA të Kosovë-Metohis — Drejtorati për dispozitat krahinore dhe organizimin — Redaktori përgjegjës Mirko Pajoviq, Prishtinë — telefoni Nr. 539. Dorëshkrimet dhe shpalljet dërgohen n'adresën: Administrata e „Fletores Zyrtare të KA të Kosovë-Metohis” në Prishtinë — Llogarija rrjedhëse Nr 21 — KB — 1 — Zh — 76 Parapagimi për vjetin 1955 kushton 500 dinarë. E shtyp Shtypshkroja „Milladin Popoviq” Prishtinë.**